VENDIM EKSTRAKT

Për kriterin e pranueshmërisë nenin 120 pika 1, shkronja "a" (nuk plotëson kriterin)

Ankuesi i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesë, në të cilën ngre pretendime lidhur me veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Pretendimet e tij lidhen me çështje të ndryshme, përfshirët masat e sigurimit, dënim alternativë, çështje civile dhe familjare.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, paraprakisht vlerëson se faktet (veprimet apo mosveprime të magjistratit) që pretendohen nga ankuesi analizohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në mënyrë të pavarur në kuadër të procesit të shqyrtimit fillestar, verifikimit apo hetimit disiplinor.

Nga shqyrtimi fillestar i ankesës referuar kritereve për pranueshmërinë e saj të parashikuara nga neni 120 i ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ne Republikën e Shqipërisë", rezulton se ankesa nuk është paraqitur në formën e përcaktuar në nenin 120, pika 1, shkronja "a" të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pasi megjithëse përmban gjeneralitetet e ankuesit dhe adresën e tij elektronike, nuk përshkruan qartë rrethanat e faktit që pretendohet se kanë ndodhur lidhur me një çështje konkrete.

Gjithashtu pavarësisht identifikimit të gjykatës dhe prokurorisë përkatëse, në ankesë nuk identifikohet ndonjë magjistrat me emër dhe mbiemër, si dhe nuk përshkruhen veprime, mosveprime apo sjellje konkrete të tij që mund të përbëjnë shkelje disiplinore dhe të jenë objekt i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pretendimet e ngritura janë paraqitur me terma të përgjithshëm dhe nuk shoqërohen me argumente apo prova konkrete që t'i lidhin ato me veprimtarinë gjyqësore ose hetimore të një magjistrati të caktuar. Për rrjedhojë, ankesa nuk plotëson kriterin e pranueshmërisë të parashikuar nga neni 120, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

Për sa më sipër, në kushtet ku nuk plotësohet kriteri i pranueshmërisë lidhur me formën dhe përmbajtjen e ankesës, nuk mund të vijohet me analizën e kritereve të tjera të pranueshmërisë. dhe ankesa duhet të arkivohet mbështetur në nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit "Për statusin".

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja "a", dhe nenit 121, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016 " Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenin 214 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar,

VENDOSA:

- Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga ankuesi, të regjistruar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- Në zbatim të nenit 121, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ky vendim t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.
- Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 (një) jave nga marrja e kë tij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.